

TOSK ENERGJI Sh.a.
Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1-3
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E KONSOLIDUAR E PERFORMANCËS	5
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	8 - 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionerët e Shoqërisë TOSK ENERGJI sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë **TOSK ENERGJI sh.a** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e konsoliduar të performancës, pasqyrën e konsoliduar të fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për opinionin me rezervë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe flukset e parashë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin me Rezervë

Sikurse është pasqyruar në shënimin 11 të pasqyrave financiare të konsoliduara, "Huamarrje afatgjata", huaja nga Gunvor S.A më 31 dhjetor 2018 është 1,822,158,000 Lekë. Nga letrat e konfirmimit të marra nga huadhënësi rezultoi një diferencë që lidhet me shumën e interesave të llogaritura për 180,994,741 leke. Kjo shumë nuk është reflektuar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Për më tepër në zërin të tjera llogari të arkëtueshme, shoqëria paraqet të drejta ndaj shoqërisë Gunvor SA për shumën 47,211,685 lek. Nga konfirmimi i marrë nga Gunvor S.A, kjo shumë është trajtuar si pakësim i detyrimeve për interesa, të cilat, siç përshkruhet në paragrafin më lartë nuk janë reflektuar në librat e shoqërisë. Si rrjedhojë, rezultati i shoqërisë është i mbivlerësuar për 180,994,741 lekë, llogaritë e tjera të arkëtueshme janë të mbivlerësuara për shumën 47,211,685 lek dhe detyrimet për interesa më 31 dhjetor 2018 janë të nënvlerësuara për shumën 133,783,056 lek.

Në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë përfshihen marrëdhëniet me Ionian Refining and Trading Company – IRTC sha (IRTC) në shumën neto prej 886,672,964 Lek nga të cilat: në llogaritë e arkëtueshme tregtare shënimi (5) përfshihen 395,539,291 Lek, në paradhënie për furnizime shënimi (8) përfshihen 633,374,722 Lek dhe në të tjera detyrime shënimi (17) përfshihen 70,485,495 Lek, në detyrim për furnizime 71,755,554. Shoqëria IRTC ka ndërprerë aktivitetin prodhues dhe gjendet në vështirësi financiare. Në bazë të marrëveshjes sigurorese datë 01.11.2017 midis dy shoqërive, për vlerën e parapagimeve të dhëna për IRTC, është sekuestruar në datën 8 prill 2018 për llogari të Shoqërisë Tosk Energji sh.a një sasi lëndësh të para dhe produkteve. Kjo sasi akoma nuk është e gatshme për përdorim nga Shoqëria Tosk Energji sh.a për shkak të procedurave doganore. Vlera e tregut e këtyre lëndëve të para dhe produkteve, në bazë të çmimit të tregut më 31 dhjetor 2018 është vlerësuar rreth 426 milion Lekë. Për sa me sipër, shoqëria duhet të kishte për llogaritur një provizion për zhvlerësim të paradhënieve dhe llogarive të arkëtueshme tregtare për të paktën 450 milion lek. Si rrjedhojë, rezultati i shoqërisë në 31 dhjetor 2018 është i mbivlerësuar për shumën 450 milion lek dhe të drejtat për arkëtim më 31 dhjetor 2018 nga shoqëria IRTC janë të mbivlerësuara për këtë shumë.

Sikurse është pasqyruar në shënimin (7) të pasqyrave financiare të konsoliduara, "Inventarë", shuma e inventareve më 31 dhjetor 2018 është 843,069,348 lekë, nga të cilat 521,039,526 Lekë përfaqësojnë gjendjen e produktit naftë virgin. Nga testimet e kryera për përcaktimin e vlerës neto të realizuar në përputhje me kërkesat e SKK 2 "Inventarët", rezultoi se për produktin naftë virgin vlera neto e realizueshme është me e vogël se vlera e inventarit të paraqitur në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2018 për shumën 56,043,435 lekë. Si rrjedhojë, rezultati i shoqërisë dhe inventaret në 31 dhjetor 2018 janë të mbivlerësuara për këtë shumë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen "Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara". Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje për t'u theksuar

Pa modifikuar opinionin tonë, ju tërheqim vëmendjen përsa i përket Shënimit 2.3 në pasqyrat financiare të konsoliduara që tregon se Shoqëria ka pësuar humbje gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2018 për shkak të mos-realizimit të volumit të planifikuar të të ardhurave prej mungesës së furnizimit me lëndë të parë. Mungesa e furnizimit me lëndë të para, përbën një pasiguri materiale për Shoqërinë për të vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

26 prill 2019


Luan Kamberi
Auditues Ligjor



TOSK ENERGJI Sh.a.*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018**

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	459,009	17,192,424
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	891,360,538	460,722,268
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	761,909,986	156,939,116
Inventarë	7	843,069,348	23,592,283
Parapadhenie dhe shpenzime të shtyra	8	650,549,036	634,045,409
Totali i aktiveve afatshkurtra		3,147,347,917	1,292,491,500
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	20,587,675	7,961,715
Aktive afatgjata jomateriale	10	508,944	402,708
Totali i aktiveve afatgjata		21,096,619	8,364,423
Totali i aktiveve		3,168,444,536	1,300,855,923
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	107,820,000	-
Qira financiare	12	1,673,050	634,390
Llogari të pagueshme tregtare	13	1,277,260,341	107,104,301
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	5,574,482	3,826,812
Detyrime tatimore	15	346,165,524	15,589,668
Parapagime te arkëtuara	16	409,814,956	2,195,733
Të tjera detyrime	17	156,149,303	74,527,556
Totali i detyrimeve afatshkurtra		2,304,457,656	203,878,460
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	11	1,822,158,000	1,017,822,869
Qira financiare	12	5,098,328	2,681,890
Totali i detyrimeve afatgjata		1,827,256,328	1,020,504,759
Totali i detyrimeve		4,131,713,984	1,224,383,219
Kapitali			
Kapitali aksionar		3,500,000	3,500,000
Rezerva perkthimi		688,813	51,471
Fitime të mbartura		72,921,233	(6,271,479)
Fitimi i ushtrimit		(1,040,379,494)	79,192,712
Totali i kapitalit	18	(963,269,448)	76,472,704
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,168,444,536	1,300,855,923

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

TOSK ENERGJI Sh.a.*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Konsoliduar e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	10,154,070,139	4,631,279,447
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	20	758,500,787	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	(38,159,555)	182,541,222
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(11,805,332,708)	(4,691,803,595)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	22	(11,604,883,078)	(4,608,215,863)
2) Të tjera shpenzime	23	(200,449,630)	(83,587,732)
Shpenzime të personelit	24	(81,384,099)	(19,109,407)
1) Paga dhe shpërblime		(75,218,006)	(17,596,117)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(6,166,093)	(1,513,290)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9/10	(2,978,779)	(605,643)
Zhvlerësim klientësh	25	(53,910,000)	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(11,186,462)	(11,075)
Shpenzime financiare		40,001,183	(5,990,477)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	27	(3,326,794)	(52,091)
2) Shpenzime të tjera financiare	28	43,327,977	(5,938,386)
Fitimi/humbja para tatimit		(1,040,379,494)	96,300,472
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	(17,107,760)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	29	-	(17,107,760)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		(1,040,379,494)	79,192,712
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		637,342	50,710
Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		637,342	50,710
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		637,342	50,710
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(1,039,742,152)	79,243,422

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

TOSK ENERGJI Sh.a.


(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në Kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Kapitali aksionar	Rezerva përkthimi	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2017	3,500,000	761	(276,891)	(5,994,588)	(2,770,718)
Transferim në fitime të mbartura					
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:			(5,994,588)	5,994,588	-
Fitimi i vitit					
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:		50,710		79,192,712	79,192,712
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	3,500,000	51,471	(6,271,479)	79,192,712	76,472,704
Transferim në fitime të mbartura					
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:			79,192,712	(79,192,712)	-
Humbja e vitit					
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:		637,342		(1,040,379,494)	(1,040,379,494)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	3,500,000	688,813	72,921,233	(1,040,379,494)	(963,269,448)

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i TOSK ENERGJI Sh.a. më ____/____/2019 dhe janë firmosur si më poshtë:


Z. Blerim Hoxha
Administrator




Z. Ilir Stafa
Hartues i Pasqyrave Financiare

TOSK ENERGJI Sh.a.
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(1,040,379,494)	79,192,712
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare	(8,324,245)	105,052,585
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	14,307,760
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	2,978,779	605,643
Zhvierësimi i llogarive të tjera të arkëtueshme	(53,910,000)	-
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(1,035,609,140)	375,958,159
Rënie/(rritje) në inventarë	(819,477,065)	(23,592,283)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	1,733,874,310	(783,627,766)
Rritje/(rënie) në parapagime të dhena	(16,503,627)	(633,984,471)
Rritje/(rënie) në parapagime të arketuara	407,619,223	2,195,733
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	11,957,003	(315,249)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(817,774,256)	(864,207,177)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(15,503,239)	(8,547,569)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jomateriale	(207,736)	(422,497)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(15,710,975)	(8,970,066)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arketuara	847,385,589	947,799,483
Arketim/(Pagesë) e detyrimeve të qirasë financiare	3,732,617	3,316,280
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	851,118,206	951,115,763
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	17,632,975	77,938,520
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	17,192,424	2,294,710
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	(35,003,732)	(63,091,516)
Rezerve përkthimi	637,342	50,710
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	459,009	17,192,424

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të kondoliduara.

TOSK ENERGJI Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

"TOSK Energji sh.a." është themeluar si një shoqëri aksionare me 17.06.2017 e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) me Kapital Fillestar prej 3,500,000 Lek. Kompania është një person juridik që vepron sipas ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë tregtare".

Shoqëria është e regjistruar në degën e tatim-taksave me NIPT L51817007A. Selia e Shoqërisë ndodhet në Rr. Papa Gjon Pali II, Qendra Tregtare ABA, Kati 13, Nr. 1303, Tiranë, Shqipëri.

Aksioneri i vetëm i shoqërisë është CFD Conseils Sarl

Objekti i aktivitetit të kompanisë është nxjerrje, shfrytezim, perpunim, import-eksport, shitje me shumice dhe tregtim i hidrokarbureve, si benzine, naftë, gas, LPG (gaz i lengshëm) CNG (gaz natural i kompresuar), bitum, lubrifikante si edhe të gjithë produktet e tjera të lidhura dhe nen-produktet e tyre dhe të gjitha aktivitetet e lidhura apo sekondare të aktiviteteve të lartpërmendura.

Pasqyrat financiare janë të konsoliduara duke përfshirë dhe pasqyrat e Tosk Energji Kosova.

Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria kishte 28 punonjës (31 dhjetor 2017:19 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Pasqyrat financiare janë të konsoliduara duke përfshirë dhe pasqyrat e Tosk Energji Kosova.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

Gjatë vitit 2018, shoqëria ka rezultuar me humbje për shkak të mos-realizimit të volumit të planifikuar të të ardhurave prej mungesës së furnizimit me lëndë të parë nga Bankers Petroleum. Në rast se Shoqëria nuk do të sigurojë furnizimin me lëndë të para, ajo mund të vihet në vështirësi financiare duke rezultuar në pamundësi të Shoqërisë për të vijuar biznesin në të ardhmen e afërt.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

TOSK ENERGJI Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara (vazhdim)****2.6. Bazat e konsolidimit**

- **Shoqëritë e kontrolluara**

Shoqëritë e kontrolluara janë njësi të kontrolluara nga Tosk Energy sh.a dhe ne rastin konkret është Dega e shoqërisë në Kosovë. Në pasqyrat financiare të konsoliduara, Shoqëritë e Kontrolluara, në të cilat Grupi kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose zoteron të drejtën për të ushtruar kontroll mbi aktivitetet e tyre, konsolidohen plotësisht. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira tek pasqyrat financiare të konsoliduara. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke u bazuar në politika kontabël uniforme për transaksione të ngjashme dhe çështje të tjera në kushte të njëjta.

- **Transaksionet e eliminuara gjatë konsolidimit**

Tepçicat brenda grupit, dhe ndonjë shumë e parealizuar e të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga transaksionet brenda grupit (përveç fitimeve ose humbjeve nga këmbimet në monedhë të huaj), janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e parealizuar janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuar, por deri në masën që nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

2.7. Krahueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të konsoliduara.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/LEK	123.42	132.95
Usd/LEK	107.82	111.10

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në bankë. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

TOSK ENERGJI Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.4 Aktive afatgjata materiale***i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Normat e amortizimit për vitin aktual janë si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Makineri Pajisje Pune	20%
Pajisje Informatike	25%
Mjete transporti	20%
Te tjera	20 %

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iii. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen kur kontrolli i një malli ose shërbimi transferohet tek një klient. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

TOSK ENERGJI Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.8 Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (për vitin 2017 është 15%) .

3.9 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare të konsoliduara. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare të konsoliduara për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare të konsoliduara por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete Monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete monetare në bankë	88,322	17,190,184
Në lekë	30,091	1,199,991
Në monedhë të huaj	58,231	15,990,193
Mjete monetare në arkë	370,687	2,240
	459,009	17,192,424

5. Llogari te arketueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Klientë brënda vëndit	887,994,997	428,607,481
Klientë të huaj	3,365,541	32,114,787
	891,360,538	460,722,268

TOSK ENERGJI Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***6. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
TVSH e arkëtueshme	201,415,066	99,340,065
TVSH e arkëtueshme në proces gjyqësor	131,152,890	
Tatim Fitimi	12,830,819	-
Akcizë për rimbursim nga dogana	150,031,709	-
Debitorë të tjere	266,479,502	57,599,051
<i>Gen Klaudis</i>	<i>53,910,000</i>	<i>55,550,000</i>
<i>Bylis</i>	<i>200,557,631</i>	<i>1,329,500</i>
<i>Gener 2</i>	<i>2,749,150</i>	-
<i>RDA</i>	<i>10,782,000</i>	-
<i>Gunvor</i>	<i>47,211,685</i>	-
<i>Të tjerë</i>	<i>667,972</i>	<i>719,551</i>
Parapagime ndaj punonjësve	4,511,064	
Zhvlerësim debitorë të tjerë	(53,910,000)	-
	<u>761,909,986</u>	<u>156,939,116</u>

7. Inventarë

Inventari më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Materiale të para	84,568,561	-
Prodhim në proces	9,059,241	-
Produkt i gatshëm	749,441,546	-
Mallra	-	16,437,312
Të tjera	-	7,154,971
	<u>843,069,348</u>	<u>23,592,283</u>

8. Paradhënie dhe shpenzime të shtyra

Paradhëniet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime të shtyra	973,637	204,238
Parapagime për inventar	649,168,113	633,374,722
Parapagime të tjera	407,286	438,735
Parapagime për punonjësit	-	27,714
	<u>650,549,036</u>	<u>634,045,409</u>

TOSK ENERGJI Sh.a.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

<i>Kosfo</i>	Mobilije dhe pajisje zyre	Pajisje informatike	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2017					-
Shtesa	1,329,508	2,686,325	3,879,040	652,696	8,547,569
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,329,508	2,686,325	3,879,040	652,696	8,547,569
Shtesa	1,841,468	885,744	5,009,904	7,766,123	15,503,239
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	3,170,976	3,572,069	8,888,944	8,418,819	24,050,808
<i>Zhvlërësimi i akumuluar</i>					
Gjendja më 1 janar 2017					-
Amortizimi i vitit	114,154	223,296	195,546	52,858	585,854
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	114,154	223,296	195,546	52,858	585,854
Amortizimi i vitit	620,800	664,340	674,563	917,576	2,877,279
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	734,954	887,636	870,109	970,434	3,463,133
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,215,354	2,463,029	3,683,494	599,838	7,961,715
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,436,022	2,684,433	8,018,835	7,448,385	20,587,675

TOSK ENERGJI Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***10. Aktive afatgjata jomateriale**

Aktivet afatgjata materiale detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	AAJM	TOTALI
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2017	-	-
Shtesa	422,497	422,497
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	422,497	422,497
Shtesa	207,736	207,736
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	630,233	630,233
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2017	-	-
Amortizimi i vitit	19,789	19,789
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	19,789	19,789
Amortizimi i vitit	101,500	101,500
Pakësime	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2018	121,289	121,289
Gjendja Neto me 31 dhjetor 2017	402,708	402,708
Gjendja Neto me 31 dhjetor 2018	508,944	508,944

11. Huatë

Në këtë zë është paraqitur hua-ja afatgjatë dhe afatshkurtër ndaj kompanisë Gunvor si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Hua afatshkurtra	107,820,000	-
Hua afatgjatë Gunvor	1,822,158,000	1,017,822,869
	1,929,978,000	1,017,822,869

12. Qira financiare

Qirate financiare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Qira financiare afatshkurtër	1,673,050	634,390
Qira financiare afatgjatë	5,098,328	2,681,890
	6,771,378	3,316,280

TOSK ENERGJI Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***13. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Furnitorë brënda vëndit	1,257,693,401	107,034,020
Furnitorë të huaj	18,700,532	70,281
Furnitorë fatura të pambërritura	866,408	-
	<u>1,277,260,341</u>	<u>107,104,301</u>

14. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime ndaj Blerim Hoxha	5,574,482	3,826,812
	<u>5,574,482</u>	<u>3,826,812</u>

15. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	1,361,488	619,702
Tatim në burim	181,948	56,917
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	1,281,748	605,289
Detyrime të tjera tatimore (takse karboni dhe qarkullimi)	343,340,340	-
Tatim fitimi	-	14,307,760
	<u>346,165,524</u>	<u>15,589,668</u>

16. Parapagime dhe të ardhura të shtyra

Parapagimet dhe të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Parapagime Spring Oil	51,198,416	2,195,733
Parapagime Ioninan Refining and Trading Company	-	-
Parapagime për shitje eksporti	358,616,540	-
	<u>409,814,956</u>	<u>2,195,733</u>

TOSK ENERGJI Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***17. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të tjera detyrime	3,274,374	1,893,385
Paga per tu paguar	11,961,434	4,431
Detyrime ndaj Ionian Refining and Trading Company	70,485,495	72,629,740
Detyrime ndaj Izvor 99	70,428,000	-
	156,149,303	74,527,556

18. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërise është 3,500,000 LEK i zotëruar 100% nga aksionari i vetëm CFD Conseils Sarl.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Numri i aksioneve	100	100
Vlera nominale (në LEK)	35,000	35,000
Kapitali i nënshkruar	3,500,000	3,500,000

19. Të ardhura të shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga shitja e mallrave	295,078,349	4,631,279,447
Të ardhura nga shitja e produkteve	9,858,991,790	-
<i>Diesel</i>	7,040,149,026	-
<i>Solar</i>	1,076,942,004	-
<i>Koks</i>	450,224,738	-
<i>Virgin</i>	1,232,219,234	-
<i>Squfur</i>	59,456,788	-
	10,154,070,139	4,631,279,447

20. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Prodhim në proces - Gjysëm produkti	9,059,241	-
Ndryshim i gjendjes sipas produkteve	749,441,546	-
<i>Diesel</i>	171,862,251	-
<i>Solar</i>	48,997,143	-
<i>Mazut</i>	4,324	-
<i>Virgin</i>	521,039,526	-
<i>Squfur</i>	7,538,302	-
	758,500,787	-

TOSK ENERGJI Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***21. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si me poshte per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga komisione ndërmjetesimi	-	280,127,268
Penalitete për mosngarkesë	-	1,206,890
Të ardhura të tjera	-	321,263
Te ardhura(shpenzime) nga këmbimit valutore neto	(38,159,555)	(99,114,199)
	(38,159,555)	182,541,222

Rakordimi i te ardhurave me FDP:

	31 dhjetor 2018
Shitje total të deklaruar në FDP TVSH	18,039,101,409
Transferime nga Ballshi ne Romano Port (për efekt deklarimi deklarohen dhe në shitje dhe në blerje)	(1,776,084,837)
Akcizë e deklaruar në shitje	(3,760,876,224)
Taksa Kombëtare të deklaruar në shitje	(2,299,077,603)
Ndryshim i gjendjes së parapagimeve të arketuara	(48,992,614)
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	10,154,070,131
Shitje produkte të gatshme	9,858,991,790
Shitje mallrash	295,078,349
Prodhim AAM	-
Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme	-
Të ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje ne FDP	10,154,070,139
Fitime nga gabime te lejuara ne ushtrimet paraardhëse	
Të ardhurat nga interesat	783
Të ardhura të tjera financiare	-
Fitim nga kembimet valutore	164,572,279
Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Ftimit	10,318,643,200
FDP e Tatim fitimit	10,318,643,200
Diferenca	-

TOSK ENERGJI Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***22. Lëndë e parë dhe materiale te konsumueshme**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Blerje materiale te para	9,117,754,799	-
Lende djegese per prodhim	919,202,453	-
Tarife rafinimi	1,197,644,996	-
Shpenzime magazinimi	25,579,139	-
Markim karburantesh	43,898,437	-
Shpenzime per analiza	17,687,729	-
Blerje Naftë	275,073,501	4,607,008,186
Penalitete për mosngarkesë	8,042,024	1,207,677
	11,604,883,078	4,608,215,863

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Blerje Energji,avull,ujë karburant	8,592,221	609,130
Shpenzime qiraje	8,406,327	2,091,980
Sigurime	2,089,527	738,123
Mirëmbajtje dhe riparime	1,198,964	254,819
Shpenzime për udhëtime, dieta	2,094,025	2,612,883
Blerje të ndryshme,kancelari etj	802,654	379,440
Tarifa portuale	25,486,746	-
Transport per shitjet	46,613,445	-
Sherbime manaxhimi	58,025,068	44,611,014
Shërbime kontabiliteti	4,389,049	2,310,426
Shërbime ligjore	1,871,828	4,819,279
Shërbime doganore	14,242,271	1,606,809
Shërbime administrative	1,877,610	667,150
Shpenzime për licenca dhe tarifa	1,161,740	1,384,362
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	334,569	172,437
Komisione bankare	1,412,774	937,296
Taksa dhe tarifa vendore	199,185	203,200
Shpenzime pritje përcjellje	4,126,748	1,807,565
Shpenzime te vitit te kaluar	-	16,398,662
Shpenzime të tjera	17,524,879	1,983,157
	200,449,630	83,587,732

TOSK ENERGJI Sh.a.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Vlerat janë në Lek)***24. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për paga	75,218,006	17,596,117
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	6,166,093	1,513,290
	81,384,099	19,109,407

25. Zhvlerësim i llogarive të tjera të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të tjera të arkëtueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Zhvlerësim llogari të tjera të arkëtueshme	53,910,000	
	53,910,000	-

26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Gjoha të ndryshme	11,164,508	3,722
Penalitete	21,954	7,353
	11,186,462	11,075

27. Të ardhura dhe shpenzime interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet e interest paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga interesi	3,327,577	52,170
Shpenzime interesi	(783)	(79)
	3,326,794	52,091

28. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Shpenzimet e tjera financiare neto paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Humbje nga këmbimet valutore të lidhura me aktivitetin e financimit	(41,519,475)	(5,938,386)
Fitim nga këmbimet valutore të lidhura me aktivitetin e financimit	84,847,452	-
	43,327,977	(5,938,386)

29. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fitimi para tatimit	(1,040,379,494)	96,300,472
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	95,876,122	20,940,963
Shpenzime udhëtimi	2,094,025	2,156,781
Gjoka dhe penalitete	11,186,462	11,074
Shpenzime pritje & percjellje	2,488,186	823,904
Humbje nga zhvlersimi	53,910,000	-
Shpenzime të vitit të kaluar	-	16,398,662
Shpenzime të tjera	26,197,449	1,550,542
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(944,403,372)	117,241,435
Humbje fiskale e mbartur	-	(3,189,704)
Fitim/ (Humbja) Fiskale	(944,503,372)	114,051,731
Tatim fitimi @15%	-	17,107,760
Fitimi Neto	(1,040,379,494)	79,192,712

30. Angazhime dhe pasiguri**Çështje gjyqësore**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta.

Me 31 dhjetor 2018 shoqëria është në proces gjyqësor me Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier si edhe me Komisionin e Apelit të Ministrisë së Financave për mosnjohjen e kreditimit të tvsh-së të parapagimeve të bëra për blerje mallrash në shumën 131 milion lekë. Bazuar në opinionin e avokateve drejtuesit të Shoqërisë, në lidhje me këtë çështje mendojnë se nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.